


Orientim karriere në teknologji

Dokumenti fillon me orientim karriere bazë në fushën e teknologjisë dhe më pas tregohen profesionet në fushën e teknologjisë për të cilat TCT ofron trajnime, për të arritur qëllimin. Për secilin profesion do të shoqërojmë disa trajnime të cilat plotësojnë dijet themelore të nevojshme për të filluar një punë të parë; duke patur parasysh që aftësitë për një profesion janë të panumërta.

Përmbajtja e dokumentit synon të drejtojë sado pak studentët të cilët janë në gjimnaz, në universitet dhe pas universitetit për të zgjedhur një profil në fushën e teknologjisë. Trajnimet praktike në fushën e teknologjisë nga Qendra e Teknologjisë Tiranë synojnë të afrojnë të rinjtë me tregun e punës.



TCT
TIRANA CENTER OF TECHNOLOGY

Rezart Alija

Mendime të sintetizuara të vendosura në letër bazuar në eksperiencë në Qendrën e Teknologjisë Tiranë!
Maj 2023

Përmbajtja

Orientim kariere në teknologji	3
Studentët e gjimnazit janë orientuar në:	3
Studentët e universitetit	4
Programimi	4
IT	4
Data	5
Ekonomist-Financier	5
Nga jashtë fushës teknologjisë, ndërrim kariere.	5
Profesione të ndryshme orientuar në teknologji - biznes	6
Masterin për çfarë t'a vazhdoj?	6
Full stack developer, a ka më të tillë?	6
Web Development	8
Frontend developer	8
JAVA Backend developer	9
C#.Net backend developer	10
Python developer	11
PHP backend developer	12
Quality Assurance	13
Software Tester (Manual)	13
Software Tester (Automated)	14
Data	15
Database developer	15
Data engineer	15
Business intelligence/Data visualization	16
Data analyst	16
Data Science	17
IT	18
Design	19
Web Design	19
Graphic Design	20

Orientim karriere në teknologji

Mundësitë e karrierave në fushën e teknologjisë janë të panumërta. Në botë, në vendet më të zhvilluara profesionet e ndryshme në këtë fushë janë shumë të profilizuara që do të thotë të detajuara dhe të thelluara në industri përkatëse. Dokumenti nuk synon të orientojë në të gjitha profesionet në IT por vetëm në ato profesione që gjenden më së shumti në Shqipëri makro rrymat, pozicione pune me kërkesa më të mëdha për punonjës dhe ku gjithësecili mund t'i arrijë nëpërmjet mënyrave të ndryshme të të mësuarit, si universitet, trajnime, video, manuale, libra etj.

Drejtimet përpjekur për të orientuar në këtë dokument janë: **IT, programim, data dhe design**. Dokumenti përpiket të kategorizojë në demografi të ndryshme duke shpresuar që ju do e gjeni vehten tek një nga kategoritë. Nga praktika e përditshme në Qendrën e Teknologjisë Tiranë kemi vënë re orientimet dhe kualifikimet si vijojnë.

Më të rëndësishmet në fillim:

1. Nëse keni një dëshirë për një nga drejtimet e mësipërme ndiqni dëshirën tuaj dhe mos u ndikoni nga ky dokument.
2. Me vullnet maksimal mund të arrini cilin do nga drejtimet IT, programim, data dhe design.

Studentët e gjimnazit janë orientuar në:

Studentët e gjimnazit duhet me patjetër të njihen me teknologjinë. Në vende të ndryshme të botës grupmosha e adoleshencës punojnë më tepër me teknologjinë se sa në Shqipëri, duke mos marroë parasysh përdorimi i rrjeteve sociale.

Tre opsionet e mëposhtme janë të të njëjtës rëndësi.

Niveli i parë në web development në Front End e cila përfshin html, css dhe JavaScript. Për arsye se Front End është më tërheqës se sa Back End, dhe se programi i zhvilluar shfaq rezultate më të prekshme në navigator si Chrome etj. Në këtë mënyrë studenti mund punojë dhe prodhojë dicka të prekshme menjëherë duke i rritur kënaqësinë për fillimin e një karriere në programim.

Niveli i parë i IT-së, diagnostikim kompjuteri dhe administrim sistemi operativ, për arsye se mëson në tërësi si funksionon kompjuteri dhe eleminon pasigurinë që vjen nga mos njohja e funksionimit bazë të kompjuterit. Plus, kjo njohuri bazë është e rëndësishme në cilin do drejtim të teknologjisë.

Design, për ju që keni një sy artistik:

- Graphic Design për ato që kanë tashmë spikatur pikturën apo artin në aftësitë e tyre. Filloni me 2D, më pas në 3D, dhe animime, bota po shkon drejt krijimit të cdo media vizive në kompjuter.
- Web Design për studentët që duan dicka më të thjeshtë se programimi, në ëeb design ndërtohen web site pa programim. Mund të vazhdohet me karriera shume të bukura si eCommerce, UX/UI user experience, Analyst etj.

Studentët e universitetit

Programimi

Web development është tregu më i madh i programuesve në vendin tonë dhe në botë. Web development ndahet në front end (user interface layer - pjesa e dukshme e aplikacionit) dhe back end layer (pjesa e padukshme, por që kryen logjikë dhe përpunim kërkesash nga përdoruesi dhe shërbimet), ndërsa ka edhe data layer (database dhe access layer për të cilën do diskutohet më pas). Për të vendosur midis një karriere në Back End dhe Front End layer në web development, si vijon:

Nëse logjika, inxhinjria, sistemet janë forte e juaja rekomandohet të vazhdoni për Back End development. Back End mund të programoni në JAVA Spring framework, C#.Net framework, PHP laravel and Python Django, të gjitha këto backed programming (middle layer) tërheqin të dhëna nga files, databaza, services, rest api, etj dhe i përpunojnë për shfaqur më tutje në Web Api End Points për Front End development layer.

Për ju që ju pëlqen programimi por logjika dhe inxhinjria nuk është forte rekomandoheni të programoni në Front End development, zhvillimi i user interface layer të një web application. Do të merrni të dhëna nga End Points të web Api nga backend layer dhe do të shfaqni të dhënat duke përdorur html, css, JavaScript dhe framework të JavaScript si ReactJS, Angular etj.

JavaScript është një gjuhë që vitet e fundit nga gjuhët e tjera.

*Së fundi, mund edhe të kaloni nga një programming layer tek tjetra pas një periudhe në punë; në këtë mënyrë mund të programoni në fullstack. Nuk rekomandohet që në fillim të përpiqeni në fullstack pasi mund të mos mësoni mirë asnjërën prej dy layers; është e rëndësishme të përmendet që njohja e layer tjetër të cilën ju nuk e keni zgjedhur ju jep një avantazh krahasues me të rintë që nuk e njohin fare layer tjetër për arsye se në skuadër do të punoni me programues që do të kryejnë zhvillim në layer tjetër dhe do të duhet të kuptoni edhe fjalorin e konceptet e tyre.

IT

Nëse programimi nuk ju ka shfaqur interes për arsye subjektive apo nuk keni qënë të mirë në lëndë logjike në shkollë atëherë IT është një karrierë më shumë potencial rritës dhe fushë veprimi shumë të gjerë. IT e cila fillohet duke kuptuar pajisjet fizike dhe sistemin e operimit të kompjuterit më pas konceptet e rrjetave kompjuterike, të serverat dhe shërbimet që ngrihen në to janë themelore për një IT me aspirata të arrijë lart. Fusha e IT-së u jep mundësi të mëdha të

punohet me infrastrukturë (client, server, rrjete, siguri) në ambient Cloud e cila po zë një vend gjithmonë e më të madh në teknologji dhe trendi tregon që Cloud do të përdoret gjithmonë e më tepër. Përvec ndërtimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës IT në premisa të kompanisë ose në Cloud, gjithashtu punojnë në Automatizimi e konfigurimeve dhe proceseve sic është profesioni i DevOps. Së fundi, Cyber Security edhe më tepër se DevOps është një profesion shumë i kërkuar dhe trendi në kohët e sotme. Cyber security ka disa seksione (profile) në këtë mënyrë keni më tepër zgjedhje në varësi të interesit dhe njohurive tuaja.

Data

Për ju që ju pëlqen logjika, matematika, statistika dhe problem zgjidhës (problem solvers) Data mund të jenë një fushë interesante për ju. Nuk do të shkruani aq shume code sa një programues por do të duhet të kuptoni më mirë dhe në thellësi se çfarë po ndodh me miliona/miliarda të dhënat që ruhen në ambientë të ndryshem në formate të ndryshme. SQL - database development dhe data engineering kërkon vëmendje të lartë dhe logjikë të fortë; shpesh duhet të kuptoni edhe biznesin për të cilin punoni në mënyrë që të pasqyroni botën fizike në atë të modelve të databazës apo proceset e lëvizjes së të dhënave. Gjithashtu, mund të zgjidhni edhe vizualizimin e të dhënave të cilat i prezantoni në dashboard nëpërmjet grafikëve dhe tabelave të ndryshme.

Për më tepër të dhëna mund të vazhdoni me gjuhët e programimit Python dhe R të cilat janë shumë, shumë, të përdorura në botën e transformimit dhe përpunimit të të dhënave. Këto gjuhë janë të rëndësishme për botën e Machine Learning dhe Data Science.

Ekonomist-Financier

Duke patur njohuri në të dhëna/data, nga puna në Excel, dhe dhënien kuptim të të dhënave ekonomistat vazhdojnë të avancojnë në drejtimin e data-ve duke marrë trajnime si MS Excel, databazë (gjuha SQL) dhe data vizualizim (PowerBI). Ekonomistat mund t'i japin kuptim të dhënave më mirë se sa një programues. Kuptimi i datave dhe data modelling është një domosdoshmëri për shumë pozicione pune.

Nga jashtë fushës teknologjisë, ndërrim karriere.

Web design dhe Digital Marketing është një profesion që do të jetë gjithmonë i kërkuar pasi ju do të ishit përfaqësuesi/marketuesit e kompanisë në internet. Cdo kompani ka nevojë të ketë një ëbsite tërheqës, funksional dhe profesional ashtu sic duhet të ketë edhe mediat sociale apo google profile të denjë dhe të paraqitshëm për kompaninë e tyre. Pasqyra e kompanisë në internet mban një pjesë të madhe të suksesit të kompanië. Puna juaj do të konsistonte pa programim por me një profilizim të thellë në ndërtim dhe mirë mbajtje website, profili në rrjete sociale, kurim fotografish etj.

Quality Assurance (Manual Software tester) pasi kërkon dije bazë në disa aftësi. Këto dije bazë mund të merren në disa trajnime të shkurtra dy mujore. Formimi i jep mundësinë të futen në botën e teknologjisë jo si zhvillues por testues ose support i skuadrave të zhvillimit. Dijet bazë janë: Bazat e quality assurance, elementët e faqes web si dhe kuptimi i të dhënave (data) në databazë dhe të jesh i aftë të ndjekësh udhëzimet/kërkesat e vendosura në kërkesat e biznesit, kuptimi i nevojave të biznesit dhe user stories.

Profesione të ndryshme orientuar në teknologji - biznes

Një sërë pozicionesh pune në me lidhje teknologjinë e informacionit janë: project manager, client relation, business analyst, product owner, scrum master, software/IT product sales etj. Këto pozicione punë kërkojnë më tepër se sa vetëm njohuri në IT por kërkojnë edhe një background në komunikim, shitje, dokumentacion, menaxhim biznesi. Sigurisht që specialistët që vijnë nga fusha të ndryshme nga teknologjia duhet domosdoshmërisht të fitojnë njohuri në produktet të gatshme në teknologji ose zhvillim produkti. Pasi të njiheni me secilin profesion vendosen aftësitë që duhet të zotëroni si edhe vendosur në CV.

Masterin për çfarë t'a vazhdoj?

Nëse keni mbaruar bachelor-in në fushën e teknologjisë masteri do të rekomandohej të lihej për disa vite më vonë që në film të punoni në fushën e teknologjisë dhe më pas të vendosni nëse dëshironi të thelloheni në teknologji duke u profilizuar në fushë më avangarde apo keni një fushë tjetër të pëlqyer që dëshironi t'ja bashkoni teknologjisë:

- Një fushë e cila lidhet me teknologjinë në tregun botëror për t'ju hapur më tepër mundësi për punë në botë por pse jo edhe në Shqipëri pasi urojmë që punë më të profilizuara do të vijnë edhe në Shqipëri. Degë si farmaci, kimi, fizikë, statistikë, matematikë, biologji, menaxhim biznesi janë disa nga degët e mundshme për t'i bashkërenduar me teknologjinë.
- Profesione më të profilizuara në teknologji si Machine Learning, Artificial Intelligence, Internet of Things, CyberSecurity, Inxhinjeri Sistemesh, Data Science janë profesione të së ardhmes.

Full stack developer, a ka më të tillë?

Profesioni fullstack developer ka filluar të përdoret nga fundi i viteve 2000 kur web application ishin monolitike dhe pak teknologji në treg. Në një botë si e sotmja, ku ka pafund gjuhë programimi dhe framework full stack developers janë pothuaj një gjë e të kaluarës. Megjithatë është bukur të kesh në staff një person të gjithë anshëm, që do të thotë të njohë edhe Java Spring framework (ose .Net, ose Laravel, ose Django) dhe të di edhe JavaScript framework si ReactJS apo të tjera framework që shfaqen shumë shpesh në botën e programimit. Një person

që i di të gjitha nuk është master në asnjë gjë. Me siguri ka full stack developer, por janë me pakicë. Kaq shpesh shfaqen të reja teknologji sa që një person nuk mund të jetë specialist në secilën prej tyre.

Për të zënë një vend pune duhet të jeni të specializuar në një development layer dhe të keni njohuri në të tjerat.

Për këtë arsye vendosni të punoni në frontend, backend, apo database development.




TCT

TIRANA CENTER OF TECHNOLOGY

Web Development

Frontend developer

Aftësitë më të rëndësishme për të filluar një profesion si frontend developer janë gjuhët web scripting. Ndryshe nga backend development, në frontend gjuhët e përdorura të quajtura scripting languages, janë: html, css, javascript, typescript dhe framework/librari të tyre.



JavaScript është një gjuhë e cila ka fituar shumë treg punë në krahasim me gjuhët e tjera të programimit në fushën e Web Applications. JavaScript është e vetmja gjuhë që përdoret për frontend development dhe ka filluar të përdoret edhe në backend development në frameëork e saj si NodeJs, NestJs etj. Trajnimet që vijojnë janë vetëm në frontend.

Në trajnimet tona gjuhët i rendisim në kurset si vijon.

1. Frontend development niveli i parë i cili përfshin HTML, CSS, bootstrap dhe JavaScript.
2. JavaScript ose TypeScript niveli intermediate në advance.
3. ReactJS ose Angular, JavaScript framework, niveli i avancuar i paketës prej tre kurseve që plotëson aftësimet për pozicion si web developer në frontend.

1. Basic script



2. Dynamic/interactive effects



3. Frameworks



JAVA Backend developer

Në përgjithësi për t'u bërë një back end developer duhet të profilizoheni/zgjidhni gjuhën backend që do të përdorni dhe SQL e cila përdoret si query language të databazës. Backend development dhe databaza janë njohuri të cilat ndërlidhen sëbashku, pasi të dhënat që tërhiqen nga backend programming layer vijnë/queries nga databaza. Në backend përdoren framework të ndryshme për të patur një web application robust dhe cilësor me funksionalitetet bazë të ndërtuara në framework. Kjo bën të mundur që programuesi të ndërtojë një web application më shpejt, të përqëndrohet në funksionalitetet e kërkuara nga klienti dhe rrisë shpejtësinë e përfundimit të projektit.



Në TCT trajnimet e rekomanduar për tu bërë një JAVA backend developer janë:

1. Java niveli i parë - konceptet themelore të gjuhës JAVA
2. Java niveli i dytë - koncepte më të avancuara dhe framework Spring etj
3. Database - SQL Quering

Gjuha e programimit Java është platform independent dhe mund të ranojë në cdo ambient.

Backend developers programojnë shtresën e poshtme të programimit dhe komunikojnë me shtresën e frontend nëpërmjet web api, ndërsa komunikojnë edhe me databazën për të tërhequr të dhënat apo ruajtur të dhëna të reja. Nuk është më e domosdoshme të bëhesh full stack developer pasi web api krijon një shtresë abstraksioni midis dy ambienteve backend dhe frontend.

C#.Net backend developer

Në përgjithësi për t'u bërë një back end developer duhet të profilizoheni/zgjidhni gjuhën backend që do të përdorni dhe SQL e cila përdoret si query language të databazës. Backend development dhe databaza janë njohuri të cilat ndërlidhen sëbashku, pasi të dhënat që tërhiqen nga backend programming layer vijnë/queries nga databaza. Në backend përdoren framework të ndryshme për të patur një web application robust dhe cilësor me funksionalitetet bazë të ndërtaura në framework. Kjo bën të mundur që programuesi të ndërtojë një web application më shpejt, të përqëndrohet në funksionalitetet e kërkuara nga klienti dhe rrisë shpejtësinë e përfundimit të projektit.

Në TCT trajnimet e rekomanduara për tu bërë një C#.Net backend developer janë:

1. C++ ose C# niveli i parë - konceptet themelore të gjuhës C++/C#
2. C#.Net niveli i dytë - koncepte më të avancuara dhe framework .NET
3. Database - SQL Quering

C#.NET Core tashmë është platform independent dhe mund të ranojë si në Windows edhe në Linux. C# është gjuhë programimi e kompiluar dhe shumë e shpejtë.



Backend developers programojnë shtresën e poshtme të programimit dhe komunikojnë me shtresën e frontend nëpërmjet web api, ndërsa komunikojnë edhe me databazën për të tërhequr të dhënat apo ruajtje të dhënave të reja. Nuk është më e domosdoshme të bëhesh full stack developer pasi web api krijon një shtresë abstraksioni midis dy ambienteve backend dhe frontend.

Python developer

Ndryshe nga një backend developer, Python developers mund të zgjedhin midis data processing and backend development.


Për sa i përket backend development, njësoj si edhe gjuhët e tjera JAVA, C#, PHP etj edhe gjuha Python ka frameworks të saj të cilat ndihmojnë në zhvillim më të shpejtë, robust me një skelet të gatshëm të web application.

Ndërsa, një opsion tjetër për Python developer është data processing e cila vazhdon në data science dhe machine learning. Në këtë drejtim librari open source të gjuhës Python kanë bërë që kjo gjuhë të jetë gjuha parësore për përpunim të dhënash. Sot të dhënat të përmasave të jashtë zakonshme të formateve të ndryshme mblidhen nga sisteme të ndryshme ku data ruhen ose rrjedhin (streaming) në vazhdimësi. Në data processing files, databaza ose integrim sistemesh bëjnë të mundur kalimin e të dhënave nga një sistem gjenerues në një sistem përpunues dhe në fund prezantues.


Trajnimet që TCT ofron janë:

1. Python niveli i parw - sintaksnw, koncepte bazw nw programim dhe data processing
2. Python niveli i dytw - Intermediate data processing, data scraping, storage, vizualization
3. SQL database development

Web development



Data processing



Backend developers programojnë shtresën e poshtme të programimit dhe komunikojnë me shtresën e frontend nëpërmjet web api, ndërsa komunikojnë edhe me databazën për të tërhequr të dhënat apo ruajtur të dhëna të reja. Nuk është më e domosdoshme të bëhesh full stack developer pasi web api krijon një shtresë abstraksioni midis dy ambjenteve backend dhe frontend.

PHP backend developer

Gjuha PHP gjen përdorime në ëeb applications development dhe në ëebsite development pasi shumica e website ndërtuara në Wordpress, Joomla apo të tjera off the shelf content management system përdorin gjuhën PHP.

Njësoj si edhe gjuhët e tjera të web development përdoren framework të ndryshme për të patur një ëeb application robust dhe cilësor me funksionalitetet bazë të ndërtuara në frameëork. Kjo bën të mundur që programuesi të ndërtojë një ëeb application më shpejt, të përqëndrohet në funksionalitetet e kërkuara nga klienti dhe rrisë shpejtësinë e përfundimit të projektit. Njohuritë në databazë janë njohuri të domosdoshme, pasi të dhënat që tërhiqen nga backend programming layer vijnë/queries nga databaza. Pamvarisht se PHP nuk përdoret për large scale web application ka avantazhin që në gjuhën PHP ndërtohen edhe shumica e ëebsite në botë, dhe jo në JAVA, C# apo Python.



Në TCT trajnimet e rekomanduar për tu bërë një PHP developer janë:

1. PHP niveli i parë - konceptet themelore të gjuhës PHP
2. PHP niveli i dytë - koncepte më të avancuara dhe framework Laravel
3. Database - SQL Querying

Quality Assurance

Kontrulli cilësisë aplikohet në shumë industri, por në TCT trajnohet në funksion të testimit të programeve, më specifikuisht web application. Në testimin e aplikacioneve web ka dy pozicion në këtë profesion: Manual dhe Automatizuar.

Software Tester (Manual)

Testuesi manual është punë më e thjeshtë se sa testuesi i automatizuar dhe përmbledhet në aftësinë për të kuptuar kërkesën e klientit për një funksion apo interfaçe, përpilimi i skenarit të testimit, kuptimi i elementëve në ëeb faqe si dhe veprimet dinamike të elementëve në ëeb faqe, dhe së fundi shkrimi i rezultatit të testimit në formatin standart. Ky profesion është më afër logjikës biznesit se sa logjikës programimit.

Trajnimet që TCT ofron janë:

1. Quality Assurance Software Tester
2. Frontend development
3. SQL database querying




Ky profesion është një mundësi e mirë për të filluar në botën e teknologjisë pa qënë programues, IT, data developer. Skuadrat të cilat zhvillojnë një program zakonisht kanë edhe një testues, pra ju do të jeni në të njëjtën skuadër pune me specialist të fushës së teknologjisë.

Software Tester (Automated)

Testuesi qw shkruan scripture pwr tw automatizuar testimin, ky lloj testimi wshtw mw i vwshtirw se sa testimi manual, wshtw nw vet vete programues i profilizuar si testues. Zhvillimi i njw programi pwr tw testuar njw program tjetwr mundwson qw produkti i kompanisw tw testohet nw cdo moment tw tij dhe tw japi rezultate tw njwjt w edhe pasi tw jenw bwrw pwrditwsime nw programming kryesor. Pamvarsisht se wshtw mw e vwshtirw pwr tu krijuar si fillim fiton kohw pwr testimet nw tw ardhmen.

Trajnimet që TCT ofron janë:

1. Quality Assurance Software Tester Manual
2. Assurance Software Tester Automated
3. Frontend development
4. SQL database quering



Data


Profesioni në botën e data-ve, një sektor që po rritet shumë në industrinë e teknologjisë së informacionit, pasi sot ruhen dhe përpunohen një sasi e stër madhe (zettabytes) data cdo ditë dhe është gjithmonë në rritje.

Pozicione pune me profil në data janë shtuar në vitet e fundit pasi ruajtja, përpunimi dhe paraqitja e data-ve janë detajuar për herë e më shumë.

Database developer

Database developers në gjuhën SQL shkruajnë queries për të tërhequr dhe përditësuar data në databazë. Gjithashtu, mund të modifikojnë dhe optimizojnë databazën, të krijojnë raporte apo procese importimi të të dhënave. Komunikojnë ngusht me backend developers për të ushqyer backend layer me të dhëna nga databaza. Krijonë data access layer si procedura, views, funksione etj. Zakonisht punojnë në databaza OLTP.

Databazat ushqejnë me të dhëna programet që në përdorim cdo ditë.



Trajnimet që TCT ofron janë:

1. SQL Query language niveli i parë
2. SQL developer niveli i dytë
3. Programim niveli i parë me gjuhën sipas preferencës


Data engineer

Data analyst/engineer implementon metoda për përmirësimin e saktësisë dhe cilësisë së data-ve. Shpesh kombinonë/bashkojnë data nga burime të ndryshme për të krijuar një strukturë të vetme si një data warehouse apo data lake. Gjithashtu, ekstraksioni, transformimi dhe ruajtja e të dhënave për në modele të para caktuara për përdorim të mëtejshëm. Përveç gjuhës SQL që duhet të zotërohet në një nivel të avancuar, njohuri në databaza NoSQL, big data dhe streaming data janë njohuri të rëndësishme. Së fundi, konceptet dhe njohuri programues në Python, C++, Java janë plus.

Trajnimet që TCT ofron janë:

1. SQL Query language niveli i parë
 - a. Vazhdim i përmirësimit të njohurive në SQL
2. Python data processing programming niveli i parë

3. Python data processing programming niveli i dytë




Data engineering është një punë që konsiderohet e stresueshme pasi janë Tera apo Peta bytes of data të cilat transformohen, kalojnë nëpër pipe lines, dhe në fund edhe data më e vogël duhet të bëhet cross check dhe të shfaqet në vendin e duhur.

Business intelligence/Data visualization

BI ose vizualizimi i të dhënave nga një analyst pas përpunimit të të dhënave nga database developer ose data engineer është përgjegjës që të ndërtojë dashboard të cilat përmbajnë grafikë dhe tabela përmblesë për paraqitje ekzekutive ose në prezantime me qëllim planifikim dhe vendim marrje.

Trajnimet që TCT ofron janë:

1. SQL - database
2. PowerBi (ose Tableau)
3. Microsoft Excel



Data analyst

Data analyst mbledh, pastron dhe analizon të dhënat. Analist mund të bëjë një punë ndërmjet data engineer dhe vizualizim të dhënash me kanotacion biznesi dhe shpjegime me pak teknike dhe me shumë business solution client relation.

Data Science

Një data scientist me një background në matematikë, statistikë, inteligjencë artificiale dhe inxhinieri kompjuterike mund të analizojë sasi të mëdha të dhënash dhe të nxjerrë kuptim nga këto të dhëna për biznesin. Shpesh herë data scientist duhet të kenë edhe njohuri të thelluara mbi industrinë të cilën aplikojnë programimin.

Trajnimet që TCT ofron janë:

1. Gjuha R
 - a. Avancim në gjuhën R
2. Gjuha Python me drejtim data processing
3. Gjuha SQL



TCT

TIRANA CENTER OF TECHNOLOGY


IT

Në profesionin e IT-së përfshihet: mirëmbajtje, mbeshtetje teknike, riparime, zhvillime të infrastrukturës, administrimi i aksesëve të brendshme, siguri e jashtme/kibernetike, deployment të sisteme-ve, cloud admin etj. Një IT mund të gjejë veten si IT i thjeshtë të pajisjeve në një kompani/institucion ose s


Në këtë fushë kaq të gjerë të teknologjisë në TCT ofrojmë trajnime të niveleve të ndryshme:

1. IT niveli i pare - Teknik PC & Administrim sistemi operativ
2. Administrim rrjete kompjuterike (CCNA)
3. Administrim Server Windows
4. Administrim Server Linux
5. DevOps

IT Bazike - Mirëmbajtje



Profilizim në nivele më të larta



IT si cdo drejtim tjetër në teknologji ka një sërë drejtimesh. Baza është e njëjtë për cilindo profesion që do të merrni: Konceptet themelore të IT-së, rrjete-ve dhe servera-ve janë bazat e IT-së. Më pas mund të profilizoheni në Cloud infrastructure, DevOps, Server Admin, Security etj.

Design


Teknologjia është një fushë e gjerë e cila gjen aplikim kudo. Kështu ndodh edhe në drejtimin e Design. Web design dhe Graphic Design janë dy profilet kryesore ku mund të përqëndrohen studentët e interesuar në design.

Web Design

Si web designer do të profilizoheni kryesisht në ndërtimin e ëbsite-ve. ëbsite kanë filluar të ndërtohen nga fillimi përdorimit të internetit pasi cdo kompani/institucion ka nevojë për një prezantim online të saj. ëbsite varrojnë nga më të thjeshtat të cilat përmbajnë përmbajtje dhe imazhe në shumë komplekse të cilat përfshijnë eCommerce, konsumimin e ëb api dhe integrimin me sisteme të tjera të brendshme (intranet) të kompanive të cilat administrojnë produktet dhe shërbimet..

Trajnimet që TCT ofron janë:

1. Web design & digital marketing - ndërtim website në platformën Wordpress, reklamim në rrjete sociale dhe Google ads.
2. Zgjedh ndërmjet profilit graphic ose zhvillues
 - a. Graphic design - Adobe Photoshop, Illustrator dhe Indesign
 - b. Frontend development - Zhvillim bazë me Html, Css, dhe JavaScript



Graphic Design

Graphic designer është një profesion në kërkesë në ditët e sotme, edhe në të ardhmen parashikohet një kërkesë në rritje. Imazhet, videot dhe animimet online janë baza e marketingut për cdo kompani dhe marketingu zë një vend të sigurt në buxhetin e cdo kompanie. Kompanitë janë duke ri-prodhuar imazhet dy dimensionale në tre dimensionale. Online ka gjithmonë e më pak imazhe dhe video reale duke u zëvendësuar me imazhe dhe video të krijuara në kompjuter.

Trajnimet që TCT ofron janë:

1. Graphic Design - Adobe Photoshop, Illustrator dhe Indesign
2. 3D Modelling - Design tre dimensional në Adobe ose Blender.



TCT

TIRANA CENTER OF TECHNOLOGY